



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Kodi i lëndës: INF 161
Lënda: Principet bazë të Infermierisë

PROGRAMI I LËNDËS									
Principet bazë të Infermierisë									
Titullari i lëndës:	Enkelejd Mëhilli, <i>PhD në Politika Shëndetësore</i> _____								
Ngarkesa:	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Labs	Praktikë	Projekte	Total		
	3 ECTS	15	0	30	0	0	45	30	75
Tipologjia e lëndës	Lëndë karakterizuese								
Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda	Viti I, Semestri I								
Lloji i lëndës	E detyruar								
Programi i studimit	Bachelor në "Infermieri Mami"								
Kodi i lëndës	INF 161								
Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës	mechilli@univlora.edu.al								

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	
Përshkrimi i lëndës	Principet bazë të Infermierisë është një lëndë formuese profesionale, e bazuar në tematikat komplekse që shtjellon si procedurat infermiore bazë, principet bazë të kujdesjeve infermiore, dokumentacioni infermior. Në këtë modul futet dhe praktika infermiore e cila në vitin e parë synon ti njohë studentët me organizmin shëndetësor në komunitet për të kaluar në vitin pasardhës në shërbimin spitalor.
Objektivat e lëndës	<p>Në përfundim të këtij kursi studentët do të kenë njohuri në drejtim të</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Njohja me profesionin e infermierit, standartet e praktikës profesionale dhe standartet e performancës profesionale.▪ Njohja, vlerësimi dhe matja e e parametrave vital.▪ Njohja me teknikat bazë infermiore në parandalimine transmetimit të infeksioneve gjatë ndërhyrjeve infermiore.▪ Veprimet infermiore gjatë vlerësimit shëndetësor të pacientit.
Rezultatet e pritshme	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none">☞ Të realizojnë përkujdesjet infermiore në bazë të mendimit kritik.☞ Të njohin standartet profesionale në praktikën infermiore.☞ Të njohin parimet e praktikës infermiore.☞ Të njohin rëndësinë e e parandalimit të transmetimit të infeksioneve gjatë përkujdesjeve infermiore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

KONCEPTET THEMELORE

1. Infermieria si shkencë
2. Të menduarit kritik në praktikën infermieorre.
3. Parimet e praktikës infermierore.
4. Vlerësimi shëndetësor dhe ekzaminimet fizike.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	<p>Tema 1- Infermieria bashkëkohore. <i>Rrregullimi i praktikës infermierore, Standartet e praktikës dhe të performancës infermierore; Përgjegjësitë profesionale; Kërkimi shkencor në infermieri; Protokollet infermierore.</i></p> <p>Laborator 1 - Kërkesat themelore të Infermierit. Laborator 2 - Njohja me spitalit, dhomën e pacientit, pajisjet e dhomës së spitalit.</p>	<i>fq. 9 - 17</i>	Leksion 1 orë <i>Laborator 2 orë</i>
II.	<p>Tema 2 - Të menduarit kritik. Proçesi infermieror, Mbledhja e të dhënave <i>Proçesi infermieror; karakteristikat e proçesit infermieror; Mbledhja e të dhënave.</i></p> <p>Laborator 3 – 4- Rregullimi i shtratit të pacientit: shtrati me pacient dhe pa pacient.</p>	<i>fq. 33 - 44</i>	Leksion 1 orë <i>Laborator 2 orë</i>
III.	<p>Tema 3 - Të menduarit kritik. Proçesi infermieror <i>Diagnozat infermierore. Përkufizimi i diagnozave infermierore; etapat; llojet; ndërtimi i diagnozave infermierore</i></p> <p>Laborator 5 – 6 - Shtrimi në spital, Akomodimi i pacientit në dhomën e spitalit. Dalja nga spitali.</p>	<i>fq. 44 - 52</i>	Leksion 1 orë <i>Laborator 2 orë</i>
IV.	<p>Tema 4 - Të menduarit kritik. Proçesi infermieror, Planifikimi i ndërhyrjeve infermierore. <i>Planifikimi është faza e katërt e proçesit infermieror, është formulimi i një plani të përkujdesjeve infermierore</i></p> <p>Laborator 7 – 8 - Qëllimi dhe teknikat e ekzaminimeve fizike, përgatitja e ambientit dhe pacientit; Pozicionet e pacientit për ekzaminim e segmenteve të ndryshme trupore; Baza e nevojshme e materialeve.</p>	<i>fq. 53 - 56</i>	Leksion 1 orë <i>Laborator 2 orë</i>
V.	<p>Tema 5 - Të menduarit kritik. Proçesi infermieror, Zbatimi dhe vlerësimi i ndërhyrjeve infermierore.</p> <p><i>Zbatimi është faza e katërt e ndërhyrjeve infermierore të planifikuara gjatë fazës së tretë të proçesit infermieror.</i></p> <p><i>Vlerësimi i ndërhyrjeve infermierore bën të mundur vlerësimin e efikasitetit të planit të asistencës infermierore të përgatitur si përgjigje e problemeve të ndryshme shëndetësore të një patienti</i></p> <p>Laborator 9 – 10 - Teknikat ekzaminimeve fizike të pacientit, Ekzaminimi subjektiv dhe objektiv.</p>	<i>fq. 56 - 59</i>	Leksion 1 orë <i>Laborator 2 orë</i>



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
VI.	<p>Tema 6 – Siguria e pacientit <i>Një mjedis i sigurt ul rrezikun për sëmundje dhe dëmtime si dhe ul koston e shërbimeve shëndetësore duke ulur në të njëjtn kohë kohëzgjatjen e hospitalizimit të pacientit</i></p> <p>Laborator 11 - Siguri e pacientit në ambjentet spitalore Laborator 12 - Lloje të ndryshme të masave për parandalimin e infeksioneve</p>	<i>fq. 83 - 90</i>	Leksion 1 orë <i>Laborator 2 orë</i>
VII.	<p>Tema 7 – Parandalimi i infeksioneve dhe kontrolli ndaj tyre <i>Zinxhiri i infeksionit; rrugët e transmetimit; procesi i infeksionit; forcat mbrojtëse ndaj infeksionit, infeksioni nosokomial; faktorët që influencojnë në parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve</i></p> <p>Laborator 13 – 14 - Masat parandaluese të infeksioneve: larja e duarve, veshja e dorezave sterile, përdorimi i maskës dhe përparësës me një përdorim</p>	<i>fq. 91 - 101</i>	Leksion 1 orë <i>Laborator 2orë</i>
VIII.	<p>Tema 8 - Etapat e procesit infermieror në parandalimin e infeksioneve <i>Personeli infermieror duhet të zbatojë disa rregulla specifike të cilat bëjnë të mundurparandalimin e infeskioneve duke zbatuar njohuritë më bashkëkohore në këtë drejtim dhe masave adekuate dhe materialeve të nevojshme</i></p> <p>Laborator 15 – 16 - Masat parandaluese të infeksioneve: larja e duarve, veshja e dorezave sterile, përdorimi i maskës dhe përparësës me një përdorim</p>	<i>fq. 101 - 114</i>	Leksion 1 orë <i>Laborator 2orë</i>
IX.	<p>Tema 9 - Matja e parametrave vital. Matja e temperaturës trupore <i>Temperatura; faktorët që ndikojnë në temperaturën humane; vendet e matjes; mjetet e punës; metodat e vlerësimit</i></p> <p>Laborator 17 – 18 - Matja e temperaturës trupore</p>	<i>fq. 123 - 135</i>	Leksion 1 orë <i>Laborator 2 orë</i>
X.	<p>Tema 10 - Matja e parametrave vital. Matja e frekuencës kardiake. <i>Pulsi; faktorët që ndikojnë në puls; vendet e matjes; mjetet e punës; metodat e vlerësimit.</i></p> <p>Laborator 19 – 20 - Matja e frekuencës kardiake</p>	<i>fq.144 - 148</i>	Leksion 1 orë <i>Laborator 2 orë</i>
XI.	<p>Tema 11 – Matja e parametrave vital. Matja e frekuencës kardiake. <i>Pulsi; faktorët që ndikojnë në puls; vendet e matjes; mjetet e punës; metodat e vlerësimit. Fq.144 - 148</i></p> <p>Laborator 21 - 22: Matja e frekuencës kardiake</p>	<i>fq 144 - 148</i>	Leksion 1 orë <i>Laborator 2 orë</i>
XII.	<p>Tema 12 - Matja e parametrave vital. Matja e frekuencës respiratore. <i>Respiracioni; faktorët që ndikojnë në respiracion; mjetet e punës; metodat e vlerësimit.</i></p> <p>Laborator 23 – 24 - Matja e frekuencës kardiake</p>	<i>fq.152 - 154</i>	Leksion 1 orë <i>Laborator 2orë</i>
XIII.	<p>Tema 13 - Matja e parametrave vital. Matja e presionit arterial <i>Presioni arterial; faktorët që ndikojnë në presionin arterial; vendet e matjes; mjetet e punës; metodat e vlerësimit.</i></p>	<i>fq.157 - 162</i>	Leksion 1 orë



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	Laborator 25 - 26: Matja e presionit arterial		Laborator 2 orë
XIV.	Tema 14 - Dokumentimi infermieror dhe kartela infermierore <i>Plotësimi i kartelës infermierore ka si qëllim të sigurojë ndjekjen dhe cilësinë e kujdesjeve infermierore në mënyrë të dokumentuar.</i> Laborator 27 - 28: Matja e presionit arterial, Plotësimi i kartelës infermierore.	<i>fq.79 - 81</i>	Leksion 1 orë Laborator 2orë
XV.	Tema 15 - Etika dhe deontologjia infermierore. Privatësia e pacientit dhe sigurimi i saj <i>Kodi etik deontologjik, parimet e etikës infermierore; dilemat etike Respektimi i privatësisë bën pjesë në një nga të drejtat e pacientit, e drejta e privatësisë lind si fillim i çdo lirie dhe si e drejtë gjithëpërfshirëse.</i> Laborator 29 -30: Hedhja e paramtrave vital në kartelën infermierore	<i>fq. 57 - 69</i>	Leksion 1 orë Laborator 2orë

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE						
FREKUENTIMI:	<p>Kërkohe një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e laboratorit janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e laboratorit në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit). Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>					
KONTROLI I VAZHDIESHËM	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provimi i pjesshem	Java 7/8	1-5 leksione 1-7 temat e laboratorit	30 pikë	Provimi me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Provimi final	Fundi i semestrit	6 – 15 leksionet 7-22 temat e laboratorit	60 pikë	Provimi me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Java 14/15	Temat e laboratorit	10 pikë	Realizim procedurash në laborator	Demostrim procedure
	*Vlerësim i vazhduar - Do të realizohet prej pedagogut të laboratorit për gjatë gjithë semestrit. Studentët do të demonstronjë në mënyrë periodike teknikat infermierore pranë manekinit.					
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare është si më poshtë:					
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
5	6	7	8	9	10	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

LITERATURA	
Literatura bazë	"Fundamental of Nursing" Edition 8, 2012. Publisher Elsevier Health Science ISBN – 13 9780323079334 (Përkthyer dhe përgatitur nga Emirjona Kicaj, Denada Selfo, Rudina Cercizaj, Rezarta Lalo dhe Alida Ramaj).
Literatura e rekomanduar	<ul style="list-style-type: none">○ Proçedurat dhe teknikat Infermierore" E. Kicaj, R. Cercizaj, R. Lalo, A. Ramaj 2010 (FSHP-UV)○ Principet bazë të Infermierisë' A.Ramaj, E. Kicaj 2011○ "Infermieri dhe administrimi i medikamenteve" A. Ramaj, E. Kicaj 2011○ "Basic Nursing – Foundations of Skills & Concepts" L.Ëhite, K.M.Campell 2002

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS	
Dispozita:	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregojnë interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
Vonesat	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
Sjellja profesionale e studentit	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mësimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijance nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit dhe të Fakultetit të Shëndetit Publik.
Integriteti akademik dhe e drejta e autorit	Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale dhe në pamundësi, të ë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzierjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.